

Procesverbal

I mbajtur me rastin e mbledhjes së komisionit për shqyrtimin e propozimeve që vijnë nga ana e qytetarëve, institucioneve, shoqatave, kryesive të fshatrave, për dhënien e shpërblimeve „Emblema e Artë“, „Skënderbeu“ dhe mirënjohjen „13 Qershori“.

Në takim morën pjesë:

Bexhet Kuçi - kryesues
Bulëza Kuçi-anëtare
Bajram Basha - anëtar
Festa Kabashi -anëtare
Adem Bytyqi - anëtar

Në takim munguan:

Jehona Rrafshi Lumi - anëtare
Destan Zekolli - anëtar

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit z.Bexhet Kuçi i cili konstatoi që ka kuorum të mjaftueshëm për të filluar takimin.

Bexhet Kuçi - kanë ardhë gjithsej 7 kërkesa brenda afatit të thirrjes publike mirëpo ka ardhë edhe një kërkesë jasht afatit e protokoluar dhe nëse jeni të pajtimit edhe këtë kërkesë me shqyrtu. Kërkesa ka ardhë nga Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj.

Bulëza Kuçi - sa kërkesa janë për çmimin 13 Qershori?

Bexhet Kuçi - gjithsej janë 4 kërkesa dhe faktikisht njëra elemeninohet sepse është dhënë çmimi për personin e propozuar dhe mbeten vetëm 3 kërkesa.

Bexhet Kuçi - e hedh në votim kërkesën e Kryetarit për diskutim.

Unanimisht Miratohet

Bexhet Kuçi - për çmimin „Emblema e Artë“ kemi 2 kërkesa. Kërkesa e parë është nga Dr.Shefket Kuçi i cili ka propozuar që çmimi „Emblema e Artë“ t’i ndahet Avdi Ramadan Berishës i cili në cilësinë e deputetit të Parlamentit të Kosovës e ka kundërshtu heqjen e autonomisë në vitin 1989 dhe nga ajo kohë ka qenë i përndjekur politik. Kryesuesi lexon biografinë e Avdi Ramadan Berishës.

Kërkesa e dytë është nga kryesia e fshatit Sallagrazhdë të cilët kanë propozuar që çmimi „Emblema e Artë“ t’i jepet Don Pren Kolës nga fshati Bec, komuna e Gjakovës. Kryesuesi lexon biografinë e Don Pren Kolës. Kryesuesi e hedh në votim propozimin e parë q Avdi Ramadan Berishës t’i ndahet çmimi „Emblema e Artë“.

Unanimisht Miratohet

Çmimi “Emblema e Artë” postmortum i jepet Avdi Ramadan Berisha për kontributin e dhënë në ngritjen e vetëdijësimin kombëtar.

Bexhet Kuçi - për çmimin “Skënderbeu” kemi 1 kërkesë nga kryesia e fshatit Peqan, shoqata e dalur nga lufta, nëndega Peqan, e cila propozon që çmimi “Skënderbeu” t’i ndahet dëshmorit Muhamet Krasniqi.

Komisioni kërkon nga propozuesit që ta sjellin certifikatën e dëshmorit kopje.Nëse sillet certifikata kjo kalon.

Kryesuesi e hedhë në votim propozimin që Muhamet Krasniqi t'i ndahet çmimi "Skënderbeu" (nëse e sjellin certifikatën e dëshmorit).

Unanimisht Miratohet

Bexhet Kuçi - për çmimin "13 Qershori" kemi 4 kërkesa.Kemi një kërkesë nga nëndega e LDK-së në Vraniq ku Dr.Shefket Kolgeci ka propozuar që çmimi "13 Qershori" t'i ndahet rapsodit Fadil Llugagjiu.

Tërhiqet nga çmimi propozimi i Shefket Kolgecit për arsye se Fadil Llugagjiu është dekoruar në vitin 2006 me mirënjohjen "13 Qershori".

Bexhet Kuçi - kërkesa tjetër vje nga OVL UÇK nëndega Samadraxhë,të cilët kanë propozuar që çmimi "13 Qershori" postmortum t'i ndahet Nystret Sali Samadraxhës.

Kryesuesi e hedh në votim kërkesën e OVL UÇK që çmimi "13 Qershori" postmortum t'i ndahet Nystret Sali Samadraxhës për kontributin e dhënë në luftën e fundit të UÇK-së.

Unanimisht Miratohet

Bexhet Kuçi - kërkesa tjetër është nga kryesia e fshatit Bllacë e cila ka propozuar që çmimi "13 Qershori" postmortum t'i ndahet humanistit Mulla Mejdi Hoxha.

Kryesuesi e hedh në votim kërkesën e kryesisë së fshatit Bllacë që çmimi "13 Qershori" postmortum t'i ndahet humanistit Mulla Mejdi Hoxha.

Unanimisht Miratohet

Bexhet Kuçi - kërkesë nga kryesia e fshatit Peqan,OVL UÇK nëndega Peqan propozon që çmimi "13 Qershori" t'i ndahet Kurtesh Fondaj.

Kryesuesi e hedh në votim propozimin e OVL UÇK nëndega Peqan që çmimi "13 Qershori" t'i jepet Kurtesh Fondaj për kontributin e dhënë në luftën e fundit të UÇK-së.

Unanimisht Miratohet

Bexhet Kuçi - kërkesa tjetër është nga Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj i cili propozon që themeluesit e "Brigadës 123" të UÇK-së të ZOP,si pako t'i ndahet çmimi "13 Qershori" z.Blerim Kuçi,z.Habib Elshani,z.Agim Kuçi,z.Ilaz Kadolli,z.Isuf Krasniqi dhe Ruzhdi Gashi.

Anëtarë i komisionit prej Shoqatave të dalura nga Lufta merr për obligim që kërkesën e propozuar apo propozimet për ish themeluesit e "Brigadës 123" ZOP ta verifikon se a janë vërtetë këta emra dhe a duhet të plotësohen me emra,në afat prej 5 ditëve,më së largu deri në datën 05.05.2025 ta sjell dokumentin me plotësim,në të kundërtën propozimi do të refuzohet.

Kryesuesi e hedh në votim kërkesën e Kryetarit.

Unanimisht Miratohet